



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

**RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VETËVLERËSIMIN E STAFIT
AKADEMIK**

2025/26

1. Hyrje

Kolegji Biznesi në Prishtinë dhe dega në Prizren, si institucion i arsimit të lartë i themeluar që nga viti 2004, ka ndërtuar dhe zhvilluar vazhdimisht një sistem të qëndrueshëm dhe të integruar për sigurimin dhe avancimin e cilësisë akademike dhe institucionale. Gjatë më shumë se dy dekadave të funksionimit, KB ka përmirësuar gradualisht mekanizmat e tij të brendshëm të cilësisë, duke i përshtatur ato me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG) dhe me kërkesat gjithnjë në rritje të proceseve të akreditimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

KB zbaton mekanizma të rregullt dhe të strukturuar për matjen dhe monitorimin e cilësisë, të cilët përfshijnë rolin aktiv të Dekanit, përgjegjësve të programeve studimore dhe koordinatorëve të cilësisë në nivel programi, si dhe **Zyrën për Sigurim të Cilësisë (ZSC)**, e cila përbën organin qendror institucional për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, koordinimin e proceseve të akreditimit dhe riakreditimit, dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga proceset e ndryshme të vlerësimit.

Në kuadër të ciklit vjetor të sigurimit të cilësisë dhe në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve akademike dhe menaxheriale, ZSC realizoi **pyetësin për vetëvlerësimin e stafit akademik** gjatë vitit akademik 2025/2026, në përfundim të semestrit dimëror. Ky instrument synonte të mbledhë vlerësime të strukturuar dhe të gjithanshme mbi cilësinë e mësimdhënies, kushtet e punës akademike, mbështetjen institucionale, mundësitë për zhvillim profesional dhe funksionimin e mekanizmave të brendshëm të cilësisë. Pyetësi ka përfshirë gjithsej 23 pyetje me alternativa, të ndara në tri kategori kryesore: kushtet e punës (9 pyetje), rezultatet e punës akademike (9 pyetje) dhe funksionimi i administratës (5 pyetje).

Procesi i hartimit, shpërndarjes dhe mbledhjes së pyetësorëve u administrua në tërësi nga ZSC, duke garantuar **anonimitetin e plotë të respondentëve**, konfidencialitetin e rreptë të të dhënave dhe integritetin e procesit, në përputhje me politikat e brendshme të KB-së për sigurimin e cilësisë, etikën institucionale dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë proces kanë marrë pjesë 12 respondentë nga dega në Prizren, të cilët kanë dhënë përgjigje të plota për secilën pyetje të parashtruar.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar në mënyrë **statistikore (kuantitative)** dhe **cilësore (përmes përgjigjeve të hapura)** , duke mundësuar një pasqyrë të plotë dhe të balancuar të gjendjes aktuale të cilësisë akademike dhe institucionale në Degën Prizren. Rezultatet e analizës shërbejnë si bazë e besueshme për identifikimin e pikave të forta, fushave që kërkojnë përmirësim, si dhe për formulimin e rekomandimeve konkrete dhe të zbatueshme për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit në aspektin akademik, menaxherial dhe strategjik.

Në këtë **raport publik** publikohen vetëm gjetjet kryesore të përgjithshme dhe të dhënat e agreguara, ndërsa rekomandimet dhe komentet e detajuara, të dhëna në mënyrë konfidenciale nga stafi akademik, përdoren ekskluzivisht për qëllime të brendshme të planifikimit strategjik, hartimit të planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimit të politikave të reja institucionale. Kjo qasje siguron respektimin e etikës profesionale, ruajtjen e dinjitetit të secilit pjesëmarrës dhe transparencën e duhur ndaj palëve të interesit të jashtëm.

2. Metodologjia e Pytesorit

Pyetësoi për stafin akademik është hartuar dhe realizuar nga **Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC)** e Kolegjit Biznesi, në kuadër të ciklit vjetor të sigurimit të cilësisë për vitin akademik 2025/2026. Ky instrument ka pasur për qëllim të mbledhë vlerësime të strukturuar dhe të gjithanshme mbi perceptimet e stafit akademik lidhur me kushtet e punës, rezultatet e punës akademike dhe funksionimin e administratës, duke shërbyer si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë institucionale.

Pyetësoi ka përfshirë **profesorët dhe asistentët** e të gjitha programeve studimore të Kolegjit Biznesi në **Prishtinë**, duke siguruar një përfaqësim të plotë dhe përfaqësues të stafit akademik të këtij kampusi. Në këtë proces kanë marrë pjesë **45 respondentë**, të cilët kanë plotësuar **45 pyetësorë** të plotë dhe të vlefshëm për analizë. Pyetësorët kanë adresuar tri fusha kryesore të vlerësimit: kushtet e punës, rezultatet e punës akademike dhe funksionimin e administratës.

Të gjithë respondentët kanë dhënë përgjigje për secilën çështje të parashtruar, duke siguruar një grup të dhënash të plota, të besueshme dhe të përdorshme për analizë statistikore dhe cilësore. Pyetësoi ka qenë **plotësisht anonim**, në përputhje me standardet më të larta të etikës akademike dhe të konfidencialitetit institucional, gjë që ka mundësuar që stafi akademik të shprehë opinione të sinqerta dhe autentike pa frikë nga pasojat.

Pyetësoi ka përmbajtur gjithsej **23 pyetje me alternativa**, të strukturuar në tri kategori tematike:

- ✓ 9 pyetje për kushtet e punës,
- ✓ 9 pyetje për rezultatet e punës, dhe
- ✓ 5 pyetje për administratën,

Secila pyetje ofronte **mundësi zgjedhjeje** në një shkallë Likert (p.sh., nga "Shumë i pakënaqur" deri te "Shumë i kënaqur" ose nga "Kurrë" deri te "Gjithmonë"), duke mundësuar një matje të kuantifikueshme dhe të krahasueshme të perceptimeve të stafit akademik.

ZSC ka realizuar **përpunimin e të dhënave** në tabelë përmbledhëse, duke llogaritur frekuencat dhe përqindjet e përgjigjeve për secilën pyetje veç e veç, si dhe duke analizuar tendencat e përgjithshme për secilën nga tri kategoritë. **Grafikonet** janë gjeneruar në mënyrë **automatike** nga të dhënat e përpunuara, për të siguruar një paraqitje objektive, të verifikueshme dhe të qartë të rezultateve. Secili grafik paraqet shpërndarjen e përgjigjeve për një pyetje specifike, duke lehtësuar krahasimin dhe interpretimin e rezultateve si nga stafi akademik ashtu edhe nga menaxhmenti i institucionit.

Pyetjet janë dizajnuar për të vlerësuar këto aspekte kryesore:

- Kushtet e punës;
- Informimin e përgjithshëm;
- Proceset e vendimmarrjes;
- Hapësirat, ambientin dhe pajisjet teknologjike;
- Realizimin e objektivave të planprogramit;
- Menaxhimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor;
- Motivimin dhe integrimin brenda Kolegjit;
- Zhvillimin profesional, pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete shkencore;
- Komunikimin dhe informimin nga administrata;
- Sfidat dhe nevojat për përmirësimin e kushteve dhe performances

3. Gjetjet nga pyetësi


Angazhimi i stafit akademik në pyetësin e realizuar gjatë **vitit 2025** konsiderohet i kënaqshëm, i gjithëpërfshirës dhe përfaqësues për strukturën e Kolegjit Biznesi në Prishtinë. Stafi akademik ka demonstruar një nivel të lartë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë gjithë procesit të vetëvlerësimit, duke i trajtuar pyetjet me seriozitet, përkushtim dhe profesionalizëm, si dhe duke ofruar përgjigje të plota, të argumentuara dhe të sinqerta në të gjitha fushat e adresuara. Ky nivel i lartë i pjesëmarrjes tregon një kulturë të zhvilluar të ndërgjegjësimit për rëndësinë e sigurimit të cilësisë dhe gatishmërinë e stafit për të kontribuar aktivisht në përmirësimin e vazhdueshëm të institucionit.

Ky raport paraqet vetëm **përmbledhjen e të dhënave statistikore** dhe **rekomandimet kryesore** që rezultojnë nga analiza e përgjithshme e përgjigjeve të stafit akademik. Qëllimi i këtij publikimi është të informojë palët e interesit të brendshëm dhe të jashtëm për gjetjet e përgjithshme dhe tendencat kryesore, pa zbuluar detaje që mund të komprometojnë konfidencialitetin e përgjigjeve individuale. Ndërkohë, **raportet e detajuara analitike**, të përgatitura nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC), të cilat përmbajnë analiza të thelluara për secilën pyetje veç e veç, ndarje sipas kategorive të vlerësimit, si dhe komente dhe sugjerime cilësore të stafit akademik, janë dorëzuar tek **Dekani**. Këto raporte do të shërbejnë si bazë për diskutime të strukturuar, të fokusuara dhe të orientuara nga zgjidhjet me stafin akademik, në funksion të identifikimit të prioriteteve, hartimit të planeve konkrete të veprimit dhe ndjekjes së


zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe institucionale.

Në vijim paraqiten **gjetjet kryesore** nga disa prej pyetjeve dhe fushave specifike të pyetësorit të realizuar me stafin akademik për **vitin akademik 2025/26**, duke përfshirë tri kategoritë kryesore të vlerësimit: kushtet e punës, rezultatet e punës akademike dhe funksionimin e administratës. Për secilën kategori, janë identifikuar pikat e forta, si dhe fushat që kërkojnë vëmendje dhe përmirësim të mëtejshëm.


Pyetësi për vlerësimin e kushteve të punës




UNË GJEJ MBËSHTETJE TE MENAXHMENTI PËR ÇDO
VËSHTIRËSI DHE SFIDË EVENTUALE




NGARKESA IME E PUNËS ËSHTË LEHTË E
MENAXHUESHME




UNË JAM NË DIJENI PËR MISIONIN, VIZIONIN DHE
QËLLIMET STRATEGJIKE TË KOLEGJIT




UNË MARRË PJESË NË PROCESET POLITIKËBËRËSE
DHE VENDIMMARRËSE TË KOLEGJIT




UNË JAM I/E LIRË TË SHPREH IDETË DHE
PROPOZIMET TE MENAXHMENTI I KB




HAPËSIRA E KOLEGJIT PLOTËSON KUSHTET PËR
REALIZIMIN E MËSIMIT EFEKTIV




HAPËSIRA ËSHTË E FURNIZUAR ME PAJISJE
ADEKUATE PËR REALIZIMIN E MËSIMIT




UNË ARRIJ QË TË PREZANTOJ NË MËNYRË TË SAKTË
QËLLIMIN DHE OBJEKTIVAT E PLANPROGRAMIT




UNË MENAXHOJ ME LEHTËSI PROVIMET DHE
VLERËSIMET E STUDENTËVE




UNË PËRDORI METODOLOGJI BASHKËKOHORE TË
MËSIMDHËNIES




NUMRI I STUDENTËVE NË SALLË ËSHTË I PËRSHTATSHËM PËR REALIZIMIN E PROCESIT




UNË NDJEHEM I/E MOTIVUAR PËR PUNËN TIME SI MËSIMDHËNËS NË KB




UNË NDJEHEM I/E INTEGRUAR BRENDA KOLEGJIT




KB ORGANIZON MJAFTUESHËM KONFERENCA SHKENCORE PËR STAFIN AKADEMIK




KB ORGANIZON MJAFTUESHËM AKTIVITETE PËR
ZHVILLIMIN E STAFIT AKADEMIK




UNË JAM I/E KËNAQUR ME MUNDËSITË E OFRUARA
NGA KB PËR ZHVILLIMIN PERSONAL





KOMUNIKIMI ME ADMINISTRATËN ËSHTË EFEKTIV



SJELLJA E ZYRTARËVE ADMINISTRATIVË ËSHTË KORREKTE DHE PROFESIONALE





REKOMANDIMET

Pas analizimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit të stafit akademik dhe komenteve të tyre, Zyra për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Biznesi i rekomandon menaxhmentit të institucionit që të ndërmerren këto masa:

1. Zhvillimi i kompetencave digjitale të stafit

Të vazhdohet dhe zgjerohet organizimi i trajnimeve të rregullta dhe të strukturuar për përdorimin e **tabelave smart, platformave digjitale** (si Google Classroom, LMS, Zoom, Microsoft Teams) dhe **mjeteve të mësimdhënies online** (interaktive, kuize, punë grupore në distancë), me qëllim të rritjes së cilësisë së ligjërimit interaktiv dhe përdorimit efektiv të teknologjisë në klasë. Rekomandohet që këto trajnime të organizohen të paktën dy herë në vit, të jenë të detyrueshme për stafin e ri dhe të hapura për të gjithë stafin ekzistues, si dhe të përfshijnë edhe aspekte praktike me raste konkrete nga përvoja e mësimdhënësve të tjerë. Gjithashtu, rekomandohet krijimi i një udhëzuesi praktik (manual) për përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënie, i cili do të shërbejë si referencë e shpejtë për stafin akademik.

2. Ofrimi i trajnimeve dhe vizitave studimore për stafin akademik

Të mbështetet stafi akademik përmes organizimit të **trajnimeve të specializuara** në fusha të ndryshme të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik, si dhe përmes **vizitave studimore** në institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Këto vizita do të mundësojnë shkëmbimin e përvojave, njohjen me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe aplikimin e tyre në kontekstin e Kolegjit Biznesi. Rekomandohet që të përpilohet një plan vjetor i trajnimeve dhe vizitave studimore, duke identifikuar prioritetet bazuar në nevojat e shprehura nga stafi akademik dhe kërkesat e programeve studimore. Gjithashtu, rekomandohet që stafi që përfiton nga këto mundësi të ndajë përvojat dhe njohuritë e fituara me kolegët e tjerë përmes seminareve të brendshme ose raporteve të shkurtra.